

“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



RAPORT TEKNIK

**“NDERTIM I URES MBI LUMIN ZEZE DHE
MBROJTJE NGA PERMBYTJET NE QYTETIN FUSHE KRUJE”**

BASHKIA KRUJE



Tiranë, Nentor 2018

P E R M B A J T J A

1. HYRJA

- 1.1 QYTETI FUSHE KRUJE
- 1.2 RILEVIMI TOPOGRAFIK DHE HARTAT BAZË
- 1.3 RRJEDHJA MAKSIMALE
- 1.4 RRJEDHJA E PLOTAVE
- 1.5 RRJEDHJA MINIMALE.
- 1.6 RRJEDHJA E NGURTE
- 1.7 UJRAT NENTOKESORE NE ZONEN E FUSHE KRUJES
- 1.8 NGRICAT NE ZONEN E FUSHE KRUJES
- 1.9 NUMRI MESATAR I DITEVE ME TEMPERATURE TOKE $< 0^\circ$

2. DETYRA E PROJEKTIMIT

- 2.1 KONSIDERATA TE PERGJITHSHME
- 2.2 TE DHENA HIDROGRAFIKE
- 2.3 DISA TE DHENA GJEOLLOGO - TEKTONIKE
- 2.4 KONSIDERATA TEKTONIKE

3. BIODIVERSITETI

- 3.1 FLORA
- 3.2 FAUNA

4. FAKTORET NDOTES DHE ROLI I TYRE

- 4.1 NDOTJET NGA SHKARKIMET E UJRAVE TE ZEZA URBANE
- 4.2 SHKARKIMET E MBETJEVE URBANE
- 4.3 NDERTIMET ARBITRARE MBI BRIGJE
- 4.4 EROZIONI

5. NDIKIMET E NDOTJEVE TE LUMIT ZEZE NE SHENDETIN E POPULLSISE

- 5.1 OBJEKTIVAT
- 5.2 METODOLOGJIA

6. ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

- 6.1 KUR NDODHIN GERYERJET E BRIGJEVE.
- 6.2 KUR NDODHIN MBUSHJET E SHTRATIT TE LUMIT
- 6.3 TEORIA E FORCËS TËRHEQËSE
- 6.4 BRIGJET E LUMIT
- 6.5 MBROJTJE NE SEGMENTIN URA E AUTOSTRADES- URA HEKURUDHORE,L = 1 390 ml

“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje

6.6 NDERTIMI I URES NE QENDER FUSHE KRUJE ,HD = 20 m

6.7 MBOJTJE NE SEGMENTIN EGZISTUES PK.29-PK.61, L = 950 ml

6.8 MBROJTJE NE SEGMENTIN Pk.61-Pk.91,L = 1 500 ml

7. VOLUMET E PUNES DHE PREVENTIVI

8 . PLAN ORGANIZIMI I PUNIMEVE

1. HYRJA

1.1. QYTETI Fush-kruje

Qyteti i Fush-krujes perfshihet ne Bashkine e Krujes. Ndodhet ne zonen qendrore te Shqipërisë. Zona e Fush-krujes kufizohet ,ne verilindje me Krujen ne jug me Tiranen,ne veri ne Lac. Siperfaqja eshte 260ha. Popullsia reth 20 00 banore. Perfshin 10 fshatra. Dendesia mesatare 700 banore per km². Popullsia qytetare 86.2%, popullsia fshatare 13.8%. Rritja natyrore 3.54%.

Mbizoteron reliivi fushor kodrinor. Lartesia mesatare e Qyetit eshte 25 m mbi nivelin e detit. Kodrat kryesore: Shqopes(111,7 m), Kodra e Bacungut (157 m), Kodra e Lagjes (383 m) etj. Fushat shtrihen ne veri e veriperendim e juglindje: Fusha Bilajit, fusha e Bubqit ne jug lindje .


Nga vrojtimet e deritanishme rezulton se maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është 39.5 gradë. Në Shqipëri ne shtresën e ajrit që është 2m larg sipërfaqes së tokës konstatohet një amplitude e lartë termike prej 68.2 grade,kjo është një vlefte e ndjeshme por gjithnjë karakterizuese për vendet mesdhetare, me një relief të thyer siç është vendi klima është e butë, në pjesën perendimore fushore ashpersohet në lindje, ku jane kodrat e malet. Temperatura mesatare vjetore ne Fush-kruje eshte 15.3°C. Temperatura mesatare e janarit 5.8°C, e korrikut 26.6°C, temperatura absolute me e ulet ne Fush-kruje eshte -13°C, me e larta absolute 38.1°C. Reshjet mesatare vjetore 1618 mm për Fush-Krujen. Kjo zone karakterizohet nga diferenca te medha intesitetesh reshjesh. Kështu në Larushk bien 1839mm,në Zall Mnerr 2763 mm. Erërat zoteruese veriperendim dhe juglindje. Në verë ndihet ndikimi freskues i puhise detare. Pasurite minerale:argjile, gure gelqeror.

1.2 . RILEVIMI TOPOGRAFIK DHE HARTAT BAZË

Rilevimi topografik i nevojsphem u krye me marrjen e detyres se Projektimit.

1.2.1 DISA TE DHENA MBI LUMIN E ISHMIT

Lumi i Ishmit shtrihet ne Shqiperine e Mesme me gjatesi 74 km, siperfaqe te pellgut ujembledhes 673 km², lartesi mesatare 357m, qe derdhet ne Gjirin e Rodonit. Formohet nga ujrat e lumit te Zezes, te lumit te Terkuzez,lumit te Tiranes dhe perroit te Bardharit. Dega kryesore e Ishmit eshte lumi i Zezes qe rrjedh nga shpatet Perendimore te Malit me Gropa. Ishmi dhe deget e tjera kryesore te tij Jane me rrjedhje te rembyeshme dhe kane çare kanione ne gelqeroret e malit te Krujes e te Dajtit si Shkalla e Tujanit, Shkalla e Bovilles dhe Shkalla e Kryemashit.



DETI ARIATIK

Zonea ujembledhese e lumbit Ishmi

Ne pjesen qendrore te lumbit te Ishmit jane formuar shtreter te gjere te mbushur me depozitime te trasha lyshterore dhe perrenje ndryshojne shpesh shtratin e rrjedhjes se tyre. Ndersa ne fushe rrjedhin me shtreter te ngushte e te larte. Prurja mesatare shume vjecare e Ishmit eshte $20.9 \text{ m}^3/\text{sek}$ me nje modul rrjedhjeje mesatar 31.0 l/sec . Prurja maksimale 1 here ne 100vjet eshte $1980 \text{ m}^3/\text{sek}$ Sasia e Lendeve te ngurta qe transporton Ishmi ne det eshte 2 milion tone. Ka mineralizim relativisht te larte 461 mg/lit temperaturat ndryshojne nga 6.2 grade ne Janar ne 24.7 grade ne gusht. Shfrytezohet per ujiten e tokave bujqesore.

Rrjedhja vjetore e Lumit te Zeses dhe te gjithe lumejnte e tjere te Shqiperise, ushqimin kryesor e kane nga rreshjet ne forme shiu. Karakteri i ndryshimeve te theksuara Stinore dhe shumevjecare ne regjimin e rreshjeve pasqyrohet edhe ne lekundjen e rrjedhjes ujore. Rregjimi i rreshjeve atmosferike, lekundshmeria e tyre, si brenda vitit, ashtu edhe ne periudhen shumevjecare, percaktojne ushqimin ujor te rrjedhjes siperfaqesore te pellgut ujembledhes, si dhe akumulimin e ujerave nentokesore.

Ne pellgun e lumbit te Zeses periudhat me më shume rreshje jane dimri dhe vjeshta, gjate te cilave bie vetem 24% deri 36% e rreshjeve vjetore. Muajt me më shume rreshje per lumin e Zeses jane Nentori dhe Dhjetori, gjate te cilave bien perkatesisht 12% ÷ 14% dhe 12% ÷ 13% te shumes vjetore te rreshjeve. Periudha e laget e vitit (tetor maj) perfshin 74% ÷ 85% te rreshjeve, ndersa ne periudhen e thatë (Korrik-Shtator) bie perkatesisht 15% ÷ 26% dhe 18% ÷ 20% te shumes vjetore te rreshjeve. Muajt me te ftoht te vitit janë Janar dhe Shkurti.

“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Përmbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje

Foto të përmbytjeve në 3 Dhjetor të vitit 2010



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje




Fotot e permbytjeve 15 Nendor 2015



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje




Foto të përmbytjeve në 23 Nendor 2016



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbajtjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje




“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbajtjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje

Pamje te gjendjes egzistuese



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



LUMI I ZEZES

Lumi i Zezes ka një sipërfaqe ujembledhese rrëth 70 km^2 me gjatesi 22 km

Burimi i tij fillon nga mali i Skenderbeut. Ne zonen malore shtrati i tij eshte i ngushte kurse ne zonen fushore ai fillon te zgjerohet .

-Formohet nga ujrat e lumbit te Zezes perroit te Bardharit dhe te perroit te Zallit, formohen në shpatet e maleve si rezultat i burimeve nëntokësore dhe i rënies së reshjeve të shiut. Per qytetin e Fush-Krujes ai ne disa raste del nga shtrati dhe permbyt pjesen e qytetit dhe zonen perreth. Mendohet se ne kete projekt ide paraprake duhet te parashikohet dhe sistemimi i lumbit qe kalon neper qytet. Te gjitha ujrat e zeza dhe te bardha derdhen ne lumin e Zezes. Lumi i Zezes ne kohen e veres eshte teper i ndotur nga hedhja e ujrate kanalizimeve dhe mbeturinave te qytetit, prandaj del i domosdoshem sistemimi i tij.

Fush-Kruja ndodhet rrëth 20 km ne veri te qytetit të Tiranës. Shtrihet rrëth kuotes 25m mbi nivelin e detit, eshte krejtesisht zone fushore, me pjerresi te terrenit $1-5\%$ me drejtim lindje-perendim. Ne afersi te saj ka disa kodra te vogla me lartesi $80-120\text{m}$ mbi nivelin e detit.

1.3 RRJEDHJA MAKSIMALE

Rrjedhja maksimale perfaqson rrjedhjen ujore qe kalon ne periudhen e laget te vitit, si dhe prurjet e plotave.

Rrjedhja ujore ne periudhen e laget te vitit eshte studiuar nepermjet vleresimit te rrjedhjes mesatare te periudhes se laget, te koeficentit te ndryshueshmerise , si dhe te koeficentit te asimetrisë .

Rrjedhja me e madhe ujore vrojtohet gjate muajve Tetor-Maj, per shkak te reshjeve te shumta atmosferike qe bien ne pellgun hidro-grafik te lumbit Zezes gjate periudhes se larget te vitit (rrëth $74-85\%$) te sasise vjetore. Rrjedhja mesatare shumevjecare e periudhes se larget u percaktua ne baze te serive te dhena te vrojtuara.

Ne pergjithesi plotat qe formohen ne rrjetin hidrografik te lumbit Zezes kane kryesisht prejardhje shiu. Analiza hidrografike me karakteristike te plotave per rrjetin hidro-grafik te ketyre lumenjve nxjerr ne dukje se plotat me prejardhje shiu formohen gjate fazes se pare te periudhes se larget te vitit (Nentor-Maj) plotat me prejardhje te perzier formohen kryesisht gjate fazes se dyte(Mars-Maj)

Gjate analizes se shirave me te medha 24-oreshe, me siguri 1% vihet re se ndryshojne ne pellgun e Zezes nga 130mm ne 244mm , me nje mesatare per te gjithe pellgun 176mm dhe ne pergjithesi jane pak me te vogla sesa ne pellgjet e lumenjeve te tjere, qe lekunden nga 126mm ne 258mm me nje mesatare 184mm ne 24 ore

Ne te dhenat e me poshteme jane paraqitur nivelet dhe prurjet perkatese me te larta per vendmatjet kryesore hidrometrike te lumbit Zeze te vrojtuara pas periudhes shumevjecare. Me qellim qe te behet nje analize e pote e te gjithe te dhenave mbi prurjet me te medha per vete rrjetin, u be plotesimi i boshllqeve dhe zgjatja e serive per te patur seri te njejte

(shiko studimin hidrologjik)

Trajtimi shumevjeçar i rrjedhjes ujore eshte bere per periudhen 1948 -1995.Kjo periudhe karakterizohet nga dy vite te laget :1962 ÷ 1963 e 1970 ÷ 1971,te cilet ,persa i perket ujeshmerise , paraqiten te rralla .Po keshtu te rralla paraqiten edhe vitet e thate:1948 ÷ 1949 dhe 1974 ÷ 1975.Per vendmatjet me seri te shkurter eshte bere zgjatja e te dhenave per peridhen 1948 ÷ 1995. Ecuria e shperndarjes se rrjedhjes ujore ne pellgun ujembledhes te te lumit te Zeses karakterizohet nga irritje te shpejta , qe perseriten disa here gjate vitit , nga nje ujeshmeri qe vazhdon per nje kohe pak a shume te gjate , nga prurje te larta ne periudhen e laget te vitit(muajt Shkurt –Mars) dhe nga nje zbrijte e theksuar e vleres se tyre gjate periudhes se thate .Nje ecuri e tille kushtezohet kryesisht nga natyra e rregjimit klimatik dhe, ne rradhe te pare , nga shperndarja ne hapesire dhe ne kohe e rreshjeve atmosferike .

Ne pjesen e siperme te pellgjeve ujembledhes te Lumit ,ku formacionet karstike zene nje siperfaqe te madhe (masivi i malit me gropa , vargmali Kruje-Dajt , etj), rrjedhin burime te shumta karstike te cilat ndikojne ne prurjet minimale gjate periudhes se veres.

Ne te dhenat e me poshteme jane paraqitur nivelet dhe prurjet perkatese me te larta per vendmatjet kryesore hidrometrike te lumit zeze te vrojtuara pas periudhes shumevjecare.

1.4 RRJEDHJA E PLOTAVE

Ne per gjithesi plotat qe formohen ne rrjetin hidrografik te lumit te Zeses kane kryesisht prejardhje shiu.Analiza e hidrografeve me karakteristike te plotave per rrjetin hidrografik te ketyre lumenjve ,nxjerr ne dukje se plotat me prejardhje shiu formohen gjate fazes se pare te periudhes se laget te vitit (nentor –mars) plotat me prejardhje te perzier formohen kryesisht gjate fazes se dyte (mars-maj).

Gjate analizes se shirave me te medha 24-oreshe , me siguri 1% vihet re se ato ndyshojne nga 130mm deri 244mm , me nje mesatare per te gjithe pellgun 176mm dhe ne per gjithesi jane pak me te vogla sese ne pellgun e lumit Erzen , qe lekunden nga 126 mm deri 258mm me nje mesatare 184mm ne 24 ore

Pas trajtimit statistikor u percaktuan koeficientet e ndryshueshmerise se serive per vendmatjet e me siperme , te cilet , ndryshojne nga 0.47 ne 1.17 .Persa i perket koeficientit te asimetrise , ai u vleresua ne baze te perputhjes sa me te mire te lakores me ate empirike.Duke ditur parametrat e serise statistikore u kalua ne llogaritjen e pleteave ne perseritje te ndryshme .

1.5 RRJEDHJA MINIMALE

Studimi i regjimit te fakteve per pellgun ujembledhes te lumit Zeze, eshte mbeshtetur ne te njejtin material hidrometrik si edhe ai i elementeve te tjere te rrjedhjes ujore. Pervec kesaj jane studiuar edhe te dhenat e ekspeditave hidrologjike mbi faktet ne pellgun e ketij lumi, si dhe te dhenat nga drejtorite e ujrave ne rrethe, qe kane te bejne me sasine e ujit qe merret nga rrjeti hidrografik per ujitje.

Si rezultat i sasise se paket te reshjeve atmosferike ne periudhen e thate te vitit (rreth 9-22% e sasise vjetore) ne regjimin e rrjedhjes se lumit zeze, ashtu si ne te gjithe lumenjte e tjere ne vendin tone, prurjet me te vogla vjetore vihen re gjate periudhes Korrik-Tetor. Gjate kesaj periudhe rrjeti hidrografik i lumenjve ushqehet

kryesisht nga ujrat e grumbulluara ne pellgun e tij hidrogeologjik. Reshet duke qene te pakta ne pjesen me te madhe te rasteve, harxhohen nje sasi per ushqimin e ujrateve nentokesor dhe sasia tjeter gjate avullimit. Ne periudhen e thate te vitit nga rrjeti i kanaleve vadites merret nje sasi e mire uji per ujite. Si pasoje rrjedhja natyrale ne periudhen e thate te vitit perfaqeshet nga sasia e ujit qe ka kaluar ne lume, si dhe nga sasia e ujit te perdonur per ujite. Ne lumin Zezes kjo rrjedhje ndryshon nga 0.50m³/sek ne 0.85 m³/sek.

1.6 RRJEDHJA E NGURTE.

Njohja e natyres se rregjimit te rrjedhjes se ngurte lumin Zezes sqaron edhe aspekte te pergjithshme te procesitte gerryerjes, qe ne kete pellg , karakterizohet nga prania e shume vatrave .Megjithese mbulesa bimore, qe perfshin perkatesisht rrreth 31% te pellgut te lumi, qe nuk eshte e dendur dhe paraqitet e shperndare ne te gjithe pellgun, ajo nuk luajt nje rol te rendesishm ne frenimin e erozionit.Ketu bejne perjashtim shkurret ,te cilat shquhen per rolin e tyre mbrojtes.Ne zhvillimin e theksuar te procesit te gerryerjes ne pellgun e ketij lumi, ndikon edhe prania e formacioneve te gerryeshme te flisht si dhe te formacioneve te tjera ranore-argjilore e argjilore,te cilat perfaqesojne nje siperfaqe te mire te pellgut ujembledhes..Keto formacione shtrihen ne shpate shume te pjerrta dhe te zhveshura .Si pasoje e kushteve te tilla fiziko-gjeografike, si dhe te sasive te konsiderueshme te rreshjeve atmosferike ,qe bien kryesisht ne muaj Tetor – Shkurt nga rrjeti i perrenjve te medhenj e te vegjel ,leviz nje sasi e ndjeshme lende te ngurte .

Ne pjesen e siperme dhe te mesme te pellgut te perbere prej kokrrizash te trasha , ne forme aluvionesh fundore , te cilat depozitohen ne shtratin e lumi qe nga pjesa e siperme e rrjedhjes deri ne zonen e tij te poshteme.

1.7 UJRAT NENTOKESORE NE ZONEN E FUSHE KRUJES

Vrojtimet e nivelit te ujit nentokesor ne zonen e Fush-krujes behen ne puse me tuba dhe ne puse te zakonshem. Edhe ne kete zone nivelet e ujit nentokesor ndjekin andamentin e reshjeve.

Rritjen me te madhe nivelet e ujit nentokesor e kane ne muajin Nentor, mbas kesaj nivelet kane qendruar afer siperfaqes se tokes deri ne Mars kur fillojne te ulen pothuajse ne te gjithe zonen e Fush-krujes me perjashtim te zonave te permbytura.

Niveli me i larte i ujrateve nentokes ne kete zone eshte vrojtuar ne muajin nentor 1962,

Ne diagramet e ndryshme te hartuara nga institucionet shkencore te vendit tone paraqiten nivelet mesatare mujore shumevjeçare dhe nivelet mesatare mujore.

Amplituda mesatare per zonen e Fush-krujes eshte nxjerre nga pikat e vrojtimit ne zona te ndryshme te qytetit e sidomos ne zonen e ulet eshte 1.40 m.

Ne muajin maj te vitit 1963 eshte vertetuar ne Fush-kruje se niveli mesatar mujor i ujit nentokesor eshte me thellesi deri ne 1.00 m nga siperfaqja e tokes .Vrojtimet e nivelit te ujit nentokesor ne zonen e Fush-krujes behen ne puse me tuba dhe ne puse te zakonshem. Edhe ne kete zone nivelet e ujit nentokesor ndjekin andamentin e reshjeve.

Rritjen me te madhe nivelet e ujit nentokesor e kane ne muajin Nentor, mbas kesaj nivelet kane qendruar afer siperfaqes se tokes deri ne Mars kur fillojne te ulen pothuajse ne te gjithe zonen e Fush-krujes me perjashtim te zonave te permbytura.

Niveli me i larte i ujrate te nentokes ne kete zone eshte vrojtuar ne muajin nentor 1962,

Ne diagramet e ndryshme te hartuara nga institucionet shkencore te vendit tone paraqiten nivelet mesatare mujore shumevjeçare dhe nivelet mesatare mujore.

Amplituda mesatare per zonen e Fush-kruje eshte nxjerre nga pikat e vrojtimit ne zona te ndryshme te qytetit e sidomos ne zonen e ulet eshte 1.40 m.

Ne muajin maj te vitit 1963 eshte vertetuar ne Fushe - Kruje niveli mesatar mujor i ujit nentokesor eshte me thellesi deri ne 1.00 m nga siperfaqja e tokes .

1.8 NGRICAT NE ZONEN E FUSH-KRUJES

Ne praktiken e perditshme ngricat konfondohen me ekstremet minimale te temperatures. Ne Hidrometeorologji me ngrice kuptohen zbritjet e temperatures ne periudhen e ftohte te vitit, deri ne ate shkalle qe demtohen rrjetet inxhinerike. Zakonisht, per rajonin qe shqyrtohet, ky kufi sillet rreth 0° C. Ngricat vrojtohen si ne Pranvere , Vjeshte dhe Dimer.

Ne Fush-kruje ndeshen te dy llojet e ngricave, fillimi dhe mbarimi i te cilave tregohen ne tabelen Nr. 1

Tab. Nr. 1

Stacioni	Sipas temperatures se ajrit			
	Fillimi	Mbarimi	Data me e Hershme	Data me e Vonshme
Fush-Kruje	6. XII	5. III	9. XI	21. IV

Tabela Nr. 1 eshte punuar sipas vlerave te temperatures minimale te ajrit.Duhet te permendim se per shkak te periudhes se shkurter te vrojtimeve dhe per mungese te te dhenave mbi demin e ngricave te rrjeteteve inxhinerike, shqyrtimi i ketij problemi paraqet veshtiresi objektive. Megjithate, per aq sa na lejon materialet ekzistues, jemi perpjekur ta trajtojme edhe kete problem.

Ngricat e vjeshtes fillojne zakonisht nga fillimi i Dhjetorit, ndersa ngricat e Pranveres zgjasin deri ne mes te Marsit. Data e fillimit dhe e mbarimit te ngrices, qe jepen ne tabele, perfaqesojne mesataren arimetike te datave shumevjeçare. Njekohesisht, po ne kete tabele, veç dates mesatare, jane dhene edhe datat ekstreme: ajo me e hershme dhe ajo me e vonshme. Sipas datave ekstreme te çfaqjes se ngricave, rezulton se ne vite te veçanta ngricat mund te zgjasin deri ne fund te Prillit dhe te filloje qysh nga mesi i Nentorit.

Nga te dhenat e tablees del qarte se per Tiranen jane me te rrezikshme ngricat e Dimrit se sa ato te vjeshtes.Rastisja e ngricave deri ne fund te Prillit,megjithese propabiliteti i çfaqjes se tyre eshte i vogel, kuptohet qe luan nje rol negativ per punimet e ndertimit ne kete kohe.

Lidhur me kete fenomen ne rajonin e Zeses ,kemi arritur ne keto konkluzione:

- a) Ne Tirane demin me te madh e shkaktojne ngricat e tipit te kombinuar advektivo-rrezatuese.Kjo shpjegohet me faktin se keto lloj ngricash vrojtohen ne periudha kur temperatura mesatare ditore e ajrit eshte e larte.

b) Shkalla e demit te ngricave eshte aq me e madhe sa me e larte te jetë temperatura mesatare e ajrit ku ndodhin ato dhe sa me e madhe te jetë shuma e temperaturave efektive dhe aktive te grumbulluara.

Temperaturat minimale absolute vrojtohen ne te gjithe zonen jo vetem gjate Dimrit por edhe ne muajt e pare te Pranveres dhe te fundit te Vjeshtes. Ky fakt paraqet nje interes te vecante, sidomos per Ndertimet Inxhinerike. Muaji me temperaturam minimale absolute me te ulta ne siperfaqe te tokes paraqitet Janari, por me vlera te aferta e nganjehere edhe me te ulta se ai, paraqiten edhe Shkurti me Dhjetorin. Vlerat e minimaleve absolute vjetore lekunden perkatesisht nga -6.5° deri ne -9.2° .

Per te njohur me mire regjimin e temperatures se tokes jepen edhe vlerat e temperatures me te larte dhe me te ulet te vrojtuara. Keto vlera te dhena per siperfaqen e tokes dhe sidomos per thellesite e ndryshme e plotesojne me mire kuptimin dhe shpjegimin e vlerave mesatare per stacionin e Fushe – Kruje verejme se temperatura me e ulet e verejtur e tokes ka zbritur nen 0° deri ne thellesine 10 cm -0.4° ne Dhjetor. Ne baze te te dhenave te viteve te fundit qe jane kryer vrojtime gjate dimrit temperatura me e ulet nen 0° ka arritur deri ne 20 cm thellesi

1.9 NUMRI MESATAR I DITEVE ME TEMPERATURE TOKE $< 0^{\circ}$

Ne te gjithe zonen periudha Maj-Shtator, dhe per rajonin bregdetar nga Fushe- Kruja e poshte edhe Tetori paraqiten pa temperatura negative te tokes. Numri mesatar me i madh i diteve me temperature $< 0^{\circ}$ vrojtohet ne Janar dhe here-here ne shkurt. Ne kete muaj ka mesatarisht rreth 17 dite ne Fush-Kruje, Pas Janarit dhe Shkurtit me numer me te madh ditesh vjen Dhjetori e pastaj Marsi. Ne Dhjetor ky numer lekundet nga 2-5 dite ne pjesen jugore ne 7-14 dite ne pjesen tjeter te zones, ne Mars nga 1-4 dite .

Ne thellesine 5 cm numri mesatar i diteve me temperature toke $< 0^{\circ}$ eshte me i madh ne Janar 3-9 dite ne 10 vjet ne shumicen e matjeve. Ne dhjetor e shkurt perkatesisht 1-8 dhe 1-5 dite ne 10 vjet. Ne nentor 1-5 dite me perjashtim te pjeses jugore .

Ne thellesine 10 cm temperaturat $< 0^{\circ}$ vrojtohen me rralle. Ne Dhjetor ka mesatarisht 1 dite por jo ne te gjithe muajin.

Ne stacionin e Fush-Krujes jepet ecja vjetore e temperatures se siperfaqes se tokes. Aty shihet se shhangjet e vlerave mesatare ekstreme dhe atyre absolute, nga vlera mesatare, jane te medha. Keto shhangje lekunden ndermjet mesatares dhe ekstremeve absolute rreth 20° mbi dhe nen vleren mesatare ne Janar dhe 33° mbi e 23° nen vleren mesatare ne Korrik. Keshtu p.sh. ndersa temperatura mesatare e siperfaqes se tokes ne Fushe-Kruje, eshte ne janar 7.9° , ato mesatare, maksimale, maksimale absolute mesatare minimale e minimale absolute, jane perkatesisht 16.3° , 27.5° , 2.9° dhe -11.8° .

Ne zonen qe studojme temperaturat maksimale absolute ne siperfaqen e tokes jane te larta. Keto paraqiten vecanerisht te tilla gjate veres si edhe ne Maj e Shtator, duke arritur mbi 60° . Maksimumet absolute vjetore vrojtohen ne Korrik, por jo rralle edhe ne Gusht. Keto lekunden nga 61.8° ne 68.4° . Ky i fundit eshte matur ne 31. VII. 1954 dhe perben vleren me te larte te verejtur jo vetem ne kete zone, por edhe ne te gjithe vendin tone.

2. DETYRA E PROJEKTIMIT

2.1 KONSIDERATA TE PERGJITHSHME

Lumi i Zeses ka një sipërfaqe ujembledhese rreth 70 km^2 me gjatesi 22 km.

Burimi i tij fillon nga mali i Skenderbeut. Ne zonen malore shtrati i tij eshte i ngushte kurse ne zonen fushore ai fillon te zgjerohet .

-Formohet nga ujrat e umit te Zeses perroit te Bardharit dhe te perroit te Zallit, formohen në shpatet e maleve si rezultat i burimeve nëntokësore dhe i rënies së reshjeve të shiut. Per qytetin e Fush-Krujes ai ne disa raste del nga shtrati dhe permbajtjet pjesen e qytetit dhe zonen perreth. Mendohet se ne kete projekt duhet te parashikohet dhe sistemimi i lumbrit qe kalon neper qytet. Te gjitha ujrat e zeza dhe te bardha derdhen ne Lumin e Zeses. Lumi i Zeses ne kohen e veres eshte teper i ndotur nga hedhja e ujrate te kanalizimeve dhe mbeturinave te qytetit, prandaj del i domosdoshem sistemimi i tij.

2.2 TE DHENA HIDROGRAFIKE

Komponentet hidrografik me te rendesishem qe formojne Perroin e Bardharit jane:

1. Perroi i Bardharit qe e ka sipërfaqen te pellgut $13,2 \text{ km}^2$, dhe ka gjatesi ne km 7.2.
2. Perroi i Halilajt qe e ka sipërfaqen e pellgut $10,9 \text{ km}^2$ dhe ka gjatesi ne km 6.5
3. Perroi i Zallit qe e ka sipërfaqen e pellgut 6 km^2 ka gjatesi km 3.2.

Nje element i rendesishem rregullator per prurjen e Zeses Jane nje sere rezervuaresh artificial qe jane ndertuar ne pjesen e sipërme te rrjedhes se tij ose mbi komponente te veçante. Keto rezervuar veç akumulimit te nje sasie te rreshjeve gjate sezonit te rreshjeve duke ulur prurjet e lumbrit ne kete fazë, sherbejne per rritjen e saj gjate stines se thate duke sherbyer njekohesisht ujerat e grumbulluara per vaditjen e tokeve qe ju poshte qendrojne.

Nga rezervuarit me te rendesishem permendim:

1. Rezervuari i Bacungut me kapacitet ujembledhes 4.2 milion m^3 , dhe lartesi dige 22m.
2. Rezervuari i Verionit me kapacitet ujembledhes 1.6 milion m^3 , dhe lartesi dige 20m.
3. Rezervuari i Dollakaj me kapacitet ujembledhes $1,75 \text{ milion m}^3$, dhe lartesi dige 22m.

Po ti shikojme elementet klimatike verejme se temperatura mesatare ditore ne vere eshte rreth $23^\circ\text{-}24^\circ$ (korrik) dhe ne dimer rreth 7.2°C (janar), kurse mesatarja vjetore eshte rreth 15°C . Amplitudat e temperaturave nga stina ne stine variojne ne menyre pothuajse konstante $6^\circ\text{-}7^\circ\text{C}$. Temperatura minimum absolut eshte shenuar ne Ballesh me 10/01/1968 me vlere -10°C dhe maksimumi absolut po ketu $41,2^\circ\text{C}$. Rezatimi diellor llogaritet $226,32 \text{ kwh/m}^2$ duke numeruar rreth 2790 ore diell ne vit.

Rreshjet. Shperndarja e rreshjeve eshte heterogjene ne kohe. Sasia kryesore bie ne periudhen e vitiit tetor-shkurt (70%). Gjate stines se veres bien vetem rrreth 1/10 e rreshjeve vjetore. Muaji me me shume rreshje eshte nentori me rrreth 140 mm. Kurse korriku eshte muaji me i thate ku bien mesatarisht vetem 23 mm rreshje. Rreshjet e periudhes se vjeshtes marrin shpesh natyre rrebeshe te rrembyer (eshte verejtur ne Fush-Kruje deri ne 22,2 mm ne 10 minuta dhe deri 50 mm per nje ore). Rreshjet e bores jane vetem 0,5 dite ne vit.

Gjate veres afersisht 90% te prurjeve te Zeses ne Fush-Kruje e perbejne ujerat urbane. Por relacioni me i plete jepet ne raportin hidrologjik.

Ererat Duke vrojtuar rozen qe jep drejtimet dhe frekuencen e ndodhjes se fenomenit vihet re se mbizoteron ere me drejtim nga jug-lindje drejt veri-perendimit e me pak lindje –perendim ose verilindje-jugperendim me nje perqindje respektive 18 %;14,4% dhe 13,8%.

Ererat qe ushtrojne veprimtarine ne rajonin jane:

- Murlani – ndihet me shume ne periudhen e dimrit, eshte me shpejtesi te madhe dhe sjell zakonisht mot te kthjellet e te ftohte. Per shkak te drejtimit te ardhjes nga verilindja njihet ndryshe me emrin “Elbasania”.
- Shiroku – quhet ndryshe “era e pelave” ndihet ne vjeshte dhe ne fund te dimrit, me drejtim nga jug e juglindje. Eshte ere e ftohte dhe e stuhishme dhe sjell mot te lagesht.
- Puhia – ndihet kryesisht ne vere ne formen e nje filadi te lehte me drejtim veri-perendim (gjate dites fryn me drejtim nga deti ne toke duke ndihmuar ne zbutjen e klimes gjate nates ndryshon kohen). Nepermjet lugines se Zeses kjo ere ushtron ndikimin e vete edhe ne brendesi te rajonit ne zonen e Balleshit.
- Juga – eshte ere e forte dhe shpesh e moderuar ne shpejtesi vjen nga jugu e jugperendimi ne dimer dhe vjeshte duke sjelle rryma te ngrohta e te ngopura me lageshti nga deti Mesdhe, krijon mot te lagesht. Ndersa gjate pranveres kjo ere eshte e ngrohte dhe e thate. Shpejtesia mesatare e eres ne rajon eshter llogaritur rrreth 2,8m/sek, kurse shpejtesia maksimale arrin deri ne 24 m/sek.

Relievi Per sa i perket aspektit morfologjik, rajoni i basenit te Zeses ndahet ne dy pjese. Pjesa lindore me relief kodrinor duke u zhvilluar ne forme trekendeshi, ne njerin kulm ne lartesite e Allkomemaj me kuote 800 m, vazhdon mandej drejt veriut per gjate kreshtes jugore te malit Skenderbeut me kuote maksimale 1198 m, Pjesa perendimore eshte fushore me ndonje me kuote nen 40m. Pra sic shihet me interesant nga ana morfologjike eshte pjesa lindore deri ne afersi te qytetit Fush-Kruje.

2.3 DISA TE DHENA GJEOLLOGO - TEKTONIKE

Persa i perket dedepozitimeve mbi te cilat rrjedh Zeza , qe nga zanafilla e elementeve formues te saj e deri ne gryke derdhje , jane te shumta e te ndryshem por qe te gjithe te natyres sedimentare. Duke filluar nga ata me te vjeterit e deri tek ata me te rintje duke ndiekur rrjedhen e lumiit nga siper-poshte po japim nje pershkrim shume sintetik.

- Depozitimet e Cretakut te siper (Cr₂)

Jane depozitime gelqerore korbonatike me ngjyre gri hiri deri ne qumeshti ne forme shtresash plakore me trashesi deri 1-2m. Takohen ne pjesen JL te basenit duke formuar maja me kuota te larta

- Depozitimet e Paleocen-Eocen i poshtem e mesem, (Pg₁-Pg₂¹⁺²)

Jane depozitime gelqeror me ngjyre gri hiri ne te bardhe. Jane gelqeror pelitomorf me nderfutje gelqerororganogjene dhe vendosen suksesivisht mbi depozitimet e Cr₂ me te cilet ngajne shume, takohen qe nga kodrat e Fush-Krujes.

- Depozitimet e Oligocenit te mesem-siper (Pg₃² - Pg₃³)

Perfaqsohen nga nje nderthurje flishore ritemholle te argjil-alevrolite e ranore me ndonje nderthurje te brezave gelqerore organogjene-coprizore. Takohen duke filluar nga kodrat mbi Fush-Kruje deri ne kodrat e Krujes.

- Depozitimet Oligocen i siper-Miocenit te poshtem (Pg₃³-N₁^{1a})

Perfaqsohen nga argjila karbonatike e alevrolit me kalime me ranore kokerimet mikore. Jane me ngjyre gri ne te kalter. Takohen gjate rrjedhes se mesme te Zeses deri ne kodrat e ishmit

- Depozitimet e Tortonian-Mesinian (N₁^{2t+m})

Duke zbritur ne rrjedhen e poshtme te Zeses ngrihem i nga kendveshtrimi gjeologjik dhe takojme depozitime me te reja te Tortonianit dhe Mesinianit. Keto depozitime takohen kryesisht ne ekstremet me veriore te kurrizeve kodrinore te permendur me larte. Formojne kodrinat qe gjenden ne jug dhe juglindje te qytetit te Fush-Krujes dhe karakterizohen nga depozitimet Argjilo-alevrolit me nderthurje ranoresh kokermesem-kokertrashe me cimentim te dobet.

- Depozitimet Mollasike te Pliocenit (N₂^{p1})

Litologjikisht perfaqesohen nga pakua ranore-alevrolit-argjile. Ne vazhdimin e kurrizit perendimore nga qafa e Nikles ne Thumane perfaqesohet litologjikisht nga pakoja ranore-konglomeratik. Trashesia e tyre ne rajon mendohet rrreth 400m.

- Depozitimet mbulesore te Quaternarit

I perkasin pothuajse teresisht seksionit Holocen. Jane formuar gjate gjithe pjeses fushore te rajonit, kryesisht nga prurjet e Zeses dhe te Ishmit. Keto depozitime vendosen trasgresivisht me ato te nenshtrira te Pliocenit si nga ana stratigrafike dhe kendore e azimutale. Perfaqesohen kryesisht nga shtresezime, pothuajse horizontale, te tipit Deluvion-Aluvialo-kenetore.

- Eluvionet e Deluvionet (Q₂^{el-del})

Jane perhapur kryesisht prane faqeve te kodrave me shkembinje rrenjesor te suites te Fushe-Krujes duke formuar trashesi qe varion nga 2-3 deri 4-5m. Perfaqesohen nga dhera me guralec e copeza te perziera me surera e suargjila. Suargjilat jane pak te lageta ne gjendje plastike dhe mesatarisht te ngjeshura.

- **Depozitimet Aluviale e Aluvialo-kenetore (Q_{2^a})**

Kane perhapje te gjere duke filluar qe nga lugina e Zeses ne rrjedhen e poshtme te saj dhe shtrihen gjate gjithe sektorit fushor te rajonit te Fush-Krujes, me trashesi qe varion nga disa metra deri ne 100m. Perfaqesohen kryesisht nga suargjila e surera ne forme nderthurjesh dhe zhavorre e zhure. Prane shtreterve te lumenjeve perfaqesohen nga surera me rera lumi e deri ne zhavorre kokerrmesem me suargjila te ngopura me uje mesatarisht te ngjeshur. Ne rajonet prane ish kenetave, takohen argjila gri te erreta te lageshta deri ne te rrjedhshme, te pangjeshura me permnjte lymi argjilor e torfe kryesisht ne zonen veri-perendimore te Fush-Krujes. Nga pikpamja gjeomorfologjike keto depozitime formojne taracen e pare te lumbit Zeza, i cili ne stadin aktual e can permes duke kaluar nga vargu Kraps-Radostine prane vargut te Mbyetit ne afersi te kishes se Shen Gjergjit, duke formuar ne zonen fushore ku gjendet qyteti i Fush-Krujes nje shtrat te ngushte e te thelle me thellesi deri ne 14m. Taraca lumore ku shtrihet qyteti i Fush-Krujes eshte e tipit akumulative me lartesi shkalle 4-8m. Trashesia e depozitimeve te shkrifta ne kete tarace varion nga disa metra reze kodrave ne jug deri 30-40 e 60m duke ju larguar kodrave drejt VL dhe VP.

2.4 KONSIDERATA TEKTONIKE

Edhe pse objekt I ketij prezantimi nuk eshte nje analize e detajuar e strukturave gjeologjike qe gjenden ne rajonin e pellgut te Zeses, per rolin shume te rendesishem qe fenomenet tektonike luajne ne cfaredo aspekt te natyres se jetes humane, nuk mundet te anashkalojme duke injoruar problemet tektonike.

Pellgu ujembledhes i Zeses si pjese perberese e Albaniteve te jashtme eshte pjese e rrudhosjes gjeosinklinale alpine. Me konkretisht pjesa e rrjedhes se siperme (zona e Zeses) eshte pjese e zones tektonike jonike, kurse rrjedha e poshtme (zona e Zeses) kryesisht eshte pjese e Ultisires prane adriatike. Depozitimet e ultisires pranadriatike aktualisht gjenden nen nje regjim tektonik shtypes, me mundesi komplikimi me shkeputje aktive te tipit larte rreshqitje-mbishtypje dhe shtytje. Jane pikerisht keto shkeputje active qe determinojne sizmicitetin e nje rajoni. Nga sinteza sizmotektonike e kryer per Shqiperine eshte se rajoni yne ben pjese ne zonen sizmologjike jonike-adriatike. Konkretisht rajoni yne gjendet prane ballit mbihypes te orogenit Shqiptar qe eshte ne konvergjence me mikropllaken e Adrias. Per rrjedhoje levizjet shtytese jane te fuqishme (Aliaj, Sulstarova). Zona sizmogjene Joniko-Adriatike paraqet nje segment te madh dhe kalon per gjate bregdetit perendifor te Malit te Zi, Shqiperise dhe Greqise, eshte e gjate deri ne 250km me gjeresi qe varion 70-80km. Te gjitha shkeputjet aktive te kesaj zone jane sizmogjene por ne na intereson me teper shkeputja aktive Durres--Vlore, per gjate te ciles shtrihen territoret qe perbejne objektin e punes sone. Kjo zone perbehet nga dy kunderhipje aktive:

- Kunderhipja e Durresit

Pergjate zones se shkeputjes Durres-Fush-Kruje-Vlore jane gjeneruar ne kohe shume termete te fuqishme permendim disa prej tyre: viti 217 me Io(intensitet epiqendor) prej VIII-IX balle ne Apolloni; ne mars 1273 me Io prej IX balle ne Durres; ne korrik te 1356 dhe mars 1551 e tetor 1851 termete me Io IX balle e MSK-64 preku Beratin; qershori 1601 dhe tetor 1851 Vlora u godit nga termete me Io IX balle. Ne shkurt 1940 zona e Cakranit u godit me termet me magnitude 5.5 dhe Io VII-VIII balle; 1959 Lushnja dhe zonat perreth u goditen nga nje termet me magnitude 6.2 dhe Io VIII-IX balle. Ne mars 1962 Fush-Kruje dhe zonat perreth u goditen nga termete me magnitude 6 shkalla rihter dhe Io VIII balle MSK 64. Ne nentor 1982 nje termet me magnitude 5.7 dhe Io VII-VIII goditi zonen e Roskovecit. Duke pasur parasysh analizen sizmo-tektonike te kryer per realizimin e rajonizimit sizmik te Shqiperise me shkalle 1:500 000 realizuar ne 1980 (Sulstarova etj) rezulton se rajoni i rrjedhes se poshtme te Zeses kryesish sektoi ku ajo përshtkon qytetin e Fush-Krujes eshte klasifikuar ne tre zona me intensitet baze te lekundjeve VII-VIII dhe IX balle te shkalles MSK 64 per kushte trualli mesatare. Territorret pergjate brigjeve te lumit me nje proabilitet 70% i perkasin zones me intensitet VIII balle MSK-64 dhe per kushte trualli te keqija mund te arrije dhe IX balle MSK-64 dhe magnitude me te madhe se 6 sipas shkalles rihter. Gjate termetit ne mars 1962, ketu u vune re fenomene te lengezimit te truallit ashtu si edhe ne brigjet e Ishmit..

Dukurite Fiziko-Gjeologjike

Ketu jane perfshire (ne pershtatje dhe me ndertimin gjeologjik dhe litologjine e pergjithshme te rajonit) dukurite e rreshqitjeve, perrenjte dhe brigjet e gerryeshem qe jane riverejtur ne kufijte e luginave te lumenjve me brigje te pambrojtura si dhe me shpate shume te pjerreta dhe brigje te thikta te tarracave te tjera. Ne rreshqitje dallohen si ato qe jane aktive ne veprim ne periudhen e tanishme dhe ato qe nuk jane aktive ose qe jane te stabilizuara por qe po te ngacmohen mund te riaktivizohen.

Ne pershtatje me karakterin, madhesine dhe aktivitetin e tyre behet e mundur qe zona te tilla te ndahan ne kategori me pershtatshmeri te kufizuar kur nuk kerkon masa te renda mbrojtese dhe te papershtatshme kur per to kerkohen masa shume te kushtueshme per qellime ndertimore ne to.

Fush-kruja karakterizohet nga nje terren fushor, me perjashtim te fare pak kodrinave te buta ne pjesen lindore te tij. Ka nje lartesi mesatare mbi nivelin e detiti prej 25 metrash, e cila varion nga 20m (ne pjesen jugore) deri ne 25m (ne pjesen veri-perendimore te qytetit).

Sipas pjerresise se siperfaqes se Fush-krujes, jane pranuar tre shkallezime pjerresie:
deri ne 10%, nga 10-20% dhe mbi 20%. Mbi bazen e ketyre kategorizimeve jane percaktuar edhe zonat ndertimore te cilat mund te klasifikohen:

1. Te pershtatshme per ndertime masive (gjithe zona fushore e qytetit,dhe ne veçanti zonat me thellesi te nivelit te ujраве nentokesore 1.5-2m d.m.th poshte tabanit te ndertimeve te zakonshme). Keto zona nuk kerkojne perqatitje te posaqme inxinerike dhe kane kushte te mire per ndertim. Ne zona te tilla pjerrisia e terrenit nuk i kalon 10%, kenetezimi mungon, nuk permbyten nga plotat e lumit Zeze ose Ishem, ujrat freatike shtrihen poshte thellesisë se vendosjes se themelive duke pranuar qe dherat e zones aktive te jene te pershtatshem per

ndertimin e veprave inxhinierike me themele te zakonshme me ngarkese te lejuar nga 1.5-3kg/cm².

2. Te pershtatshme me kusht (jane zonat buze brigjeve te lumi Zeze ku thellesia e shtrirjes se ujrade nentokesore eshte me pak se 1.5m) Ne to jane perfshire zonat me pjerresi te terenit nga 10-20% dhe terenet te rrafshet me nivel te larte te ujrade freatike, zonat apo sheshet e perbere nga dhera te dobeta nga pikpamja ndertimore te te cilat hyjne depozitimet e ndryshme teper te shtypshme dhe me qendrueshmeri te vogel ndaj rreshqitjes.

Te papershtatshme ose me pershtatshmeri te kufizuar. Karakterizohen nga kushte te vecanta natyrore, prania e te cilave nuk lejon sigurimin e qendrueshmerise dhe punen normale te ndertesave ose veprave te tjera inxhinierike ose mund ti nderlikoje se tepermi ato duke rritur shume koston e ndertimit. Ne kete kategori perfshihen terrene me pjerresi me te madhe se 20% zona te kenetezuara se tepermi (zona e pjeses se taraces zalleshtore dhe te taraces se pare te lumi Zeze te cilat vazhdimisht jane ne ndikimin e permbytjeve gjate plotave te lumi). Gjithashtu edhe pjeset prane brigjeve te lumi qe jane ne ndikimin e dukurive gerryese erozive dhe shembjeve bregore.

Per sa i perket gjendjes se brigjeve te Zeses erozionit, shembjeve, gjendjes se shtratit, bllokimeve e ngushtimeve artificiale nga shkarkimet abuzive te mbetjeve te ngurta urbane apo ndertimet te pa mirestudiura mendojme se duhet bere nje studim me i detajuar me vrojtime direkte ne terren per te bere nje pasqyrim me realist te nivelit te kuotave te shtratit dhe sasine e materjaleve te hedhura brenda tij.

Te dhena pedologjike

Duke konsideruar teresine e faktoreve qe ndikojne ne llojin dhe cilesine e tokes, qe nga ato klimatike, litologjik, morfologjik, hidro-gjeologjike eshte vene re se ne zonen tone ne pjesen e lugines se Zeses mbizoterojne tokat te hirta-kafe deri ne te kafenja. Kurse ne shpatet e kodrinave dominojne toka te varfra me humus.

3. BIODIVERSITETI

Per vet kushtet klimatike dhe pozicionin gjeografik ku gjendet rajoni i lugines se Zeses ai eshte shume i pasur me shumellojshmeri faune dhe flore. Me poshte japim nje prezantim te shkurter te tyre.

3.1 FLORA

Per efekt prezantimi sa me efektiv kemi bere nje nendarje ne grupe te flores.

Flora natyrale – Bime tokesore

a) Zonat me pyje

Kjo zone eshte shume e pasur me flore natyrale si peme, shkurre dhe vegjitacion tokesore. Pyjet shtrihen ne nje zone te konsiderueshme kryesisht ne kodra. Ne keto pyje gjenden specie te ndryshme pemesh, peme gjethegjere te familjes Fagaceae, te tilli si Quercus coccifera, Quercus robur, Quercus trojana etj. Nga familja Ulmaceae gjenden Ulmus campestris. Ne kete zone ka gjithashtu peme te familjes Salicaceae, kryesisht Salix alba dhe Populus alba.

Te nje rendesie te vecante jane pyjet konifere perfaqesuar nga Familja Pinaceae me speciet Pinus pinea dhe Pinus halepensis. Ne katin e dyte te pyllit gjenden shkurret e pyllit te familjes Ericaceae, familja Rozacea perfaqesojet nga Rozacamina etj.

b) Zona me shkurre

Ne pyje dhe prane zonave me shkurre jane *Cistus salvifolius* dhe *Thymus capitata*. Perfaqesues nga familja Anacardiaceae jane *Tistecia terelinthus* dhe *Pistacia lentiscus*. Kategoria e trete e bimeve natyrale janë vegjetacioni i tokes ose bimet e egra. Ato rriten nen druret pyjore, ullinjte, ne ane te rrugeve, ne kanale, ne fshat dhe ne qytet, gjithashtu gjenden edhe ne toka te kultivuara se bashku me drithrat, duhanin, perimet dhe kulturat e tjera bujqesore. Duhet te theksohet se ato rriten me mire sidomos ne parcela te pa kultivuara.

Nen ullinjte dhe peme te tjera gjenden :

- *Inula viscosa*
- *Centaureasolstitialis*
- *Xanthium strumarium*
- *Chicoriumintybus* i families *Camposampoticaea*
- *Ammivisnaga* dhe *Daucus carota* (familia Umbeliferae)
- *Cynodon Daktylon*
- *Anthoxanthum adorathum* (Gramunacea)
- *Salvia hormine* dhe *phlomis fruiticosae* (Labiateae)

Specie qe shoqerohen me kulturat bujqesore:

- *Cynodon dactylon*
- *Sorghum halepens*
- *Avena fortuna*
- *Lolium perense phalaris arundinaceae*
- *Abutilon theophrasti*
- *Solomon nigrum*
- *Vicia Lutea, V. Sativa, V. Villosa*

Vegjetacioni ne zonat urbane dhe ne ane te rrugeve:

Pervec kulturave bujqesore ka specie te cilat rriten ne fshatrat e rajonit te Fush-krujes, prane gardheve, ne kopesht, ne ane te rruges. Speciet kryesore janë:

- *Graminoza* (*Cynodon dactylon*)
- *Leguminosaeae* (*Trifolium sponios spinosa*)
- *Malvaceae* (*Malva silvetris*)
- *Poligonaceae* (*Poligoneumavikulare*)
- Etj.

c) Bimet e ujit

Ne ane te kanaleve dhe lunjenjeve gjenden bimet e me poshtme:

- *Paspelum distichum*
- *Phragmites communis*
- *Typha latifolia*
- *Typha augustifolia*
- *Equisetum palustre*(Familja Equiseteceae)
- Etj.

Ne ane te lumenjeve ndodhen gjithashu peme dhe shkurre per shkak te lageshtise gjate gjithe vitit. Pemet kryesore qe gjenden janë:

- *Salix alba*

- *Populus alba* (Salicaceae)
- *Plantanus orientalis* (Plantanaceae)
- *Ulmus campestris* (Ulmaceae)

Ka gjithashtu shkurre te dendura, kryesisht *Robus ulmifolius*, te cilat formojne nje mbulese si dhe *Tamarix paeviflora* (*Tamarix*) por kjo eshte shume e rralle.

Ka shume specie bimesh ne ane te lumenjeve dhe kanaleve, kryesishte te familjes Compositaceae:

- *Silybum marianum*
- *Xanthium strumarium*
- *Inula viscosa*
- *Senecio vulgaris*
- *Centarea Solstitialis*
- *Tussilago farfara*
- Etj.

d.Bimet e kultivuara

Druret; druri me i rendesishem eshte ulliri, *Olea europea*, per shkak te klimes. Pervec ullirit permendim dhe specie te tjera kultivuese si molla (*malus*), pisha (*pinus*), kumbulla (*prunus*), fiku (*ficus*), mana (*Morus alba* sp), si edhe vreshte kryesisht prane shtepive dhe ne kopshte (*vitis vinifera*).

Shumica e tokes eshte me drithera – *Triticum* (grure) dhe *Zea mays* (miser).

Nga kulturat Agro-industriale *Grossypium hirsutum* zinte nje perqindje prej 15-20% por nuk kultivohet me, po keshtu edhe *Helianthenum* sp. (luledielli). E vetmja bime industriale qe rritet tani eshte *Nicotiana tabacum* (duhani). Nje sipërfaqe e konsiderueshme i eshte kushtuar foragjereve si *Medicago*, *Trifolium*, *Brassica oleracea*.

Per sa i perket perimeve, bazuar ne sipërfaqen e mbjelle dhe ne rendesine qe ato kane per njerezit mund ti rradhishim si me poshte:

Lilioveal	<i>Allium cepa</i>
	<i>Allium sotium</i>
	<i>Allium porrum</i>
Cucurlita	<i>Citullus vulgaris</i>
	<i>Cucunus sativus</i>
	<i>Cucunus melo</i>
	<i>Cucurbita pepo</i>
	<i>Cucurbita maxim</i>

3.2 FAUNA

Fauna ujore

Sic eshte permendur edhe me siper rrjeti hidrografik i rajonit eshte shume intensive. Pervec lumenjeve Ishem dhe Zeze, jane dhe disa kanale ujites dhe kullues dhe shume perrenje te vegjel. Fauna e kesaj zone ka qene shume e pasur shume vite me pare

Ne rrjetin hidrik te kanaleve jane gjetur invertebrore te tille si: Lumbricus terestriste te familjes Lumbricidae dhe Hirudo midicinales te familjes Hirudidae. Kafshet e Phylum Mollusca jane gjendur ne gjethet e bimeve te ujit Lymnea tentacula te familjes Lymnaeidae. Gjithashtu verehen kafshe uji invertebrore si peshqe te ndryshem: amphibians, si Rana eperioptera; reptile si Natrix terellata dhe Emys orbicularis.

Fauna tokesore (kafshët)

Duke u bazuar ne diskutime me njerez banore ne kete zone ne intervistat me gjahetare dhe ne pervojen e biologjisteve, u konkludua se fauna tokesore e llojeve te ndryshem egziston ne zone per shkak te egzistences se pyjeve, luginave, kullotave. Psh reptili Testudo hermanni eshte zhdukur. Ne te kaluaren keta reptile sherbenin si ushqim per derrat dhe shpendet si dhe gatuveshin. Zogje shtetetare si Ciconia ciconia dhe Ciconia nigra, Anser erythropus, Branta ruficollis, Tringa ochropus nuk jane pare per shume vite. Kafshe te tillë si: Lepurus europaeus, Lamis lupus, Carnis aureas, Mustelle nivaleas, Meles meles, Talpe ceca tani jane ne nje numer te vogel.

4. FAKTORET NDOTES DHE ROLI I TYRE

Le te shohim tani me nga afer kush jane faktoret konkrete dhe rolin e tyre ne shnderrimin e Zeses, ne nje lum pa jete dhe te demshem per jeten.

4.1 NDOTJET NGA SHKARKIMET E UJRAVE TE ZEZA URBANE

Nje faktor tjeter me ndikim negativ shume te fuqishem ne ndotjen e lumit Zeze, jane edhe ujrat e zeba urbane te cilat shkarkohen ne kete lum. Aktualisht ne Fush-kruje, nuk eshte realizuar ende ndarja e ujrade te zeba nga ujrat e tjera urbane, dhe nje pjese e konsiderueshme e tyre (rreth 20%) derdhen ne kete lum, kryesisht ne lum derdhen ujrat e lagjeve, nje pjese e lagjes. Gjithashtu ne lum derdhen te paperpunuara edhe ujrat e aktiviteve ekonomike qe zhvillohen aktualisht ne Fush-kruje. Eleminimi i ketyre ujrade nepermjet krijimit te nje sistemi kanalizimesh qe do te konvergojne ne nje pike te vetme qe do te jete hapi i pare dhe i domozdoshem per te mundesuar me vone realizimin e depurifikimit te ketyre ujrade para se ato te derdhen ne sistemin hidrik siperfaqesor.

4.2 SHKARKIMET E MBETJEVE URBANE

Mbetjet urbane jane nje faktor tjeter shume i rendesishem qe ndikon ne prishjen e ekosistemit te lumit Fush-kruje. Shkarkimet abuzive te ketyre mbeturinave (sidomos gjate viteve te tranzicionit) ka bere qe te modifikohet profili i lumit duke e ngushtuar ate vende-vende dhe shpesh here duke krijuar edhe “tapa” mbeturinash qe ulin ne menyre te ndieshme kapacetetin percjelles te lumit faktor ky qe rrit ndieshem potencialin permbytes te lumit gjate rreshjeve te fuqishme ne pellgun ujembledhes te tij, pare kjo edhe ne situaten kur edhe shtrati i lumit eshte i mbathur nga depozitimet aluviale per shkak te mosnderhyrjeve per nje kohe te gjate per pastrimin e tij. Eshte konstatuar disa here gjate viteve situata te tillë permbytjeje sic Jane ato te vitit 2002 kur u permbyten territore deri ne kuoten 28.0 m Mbahet si kuote e rrezikuar nga permbytjet e mundeshme akoma edhe sot. Per te paraprire mundesine e permbytjeve pervec pastrimit te profitit te lumit dhe te shtratit te tij do te ishte e nevojshme edhe mundesia e aktivizimit te rezervuarve ne pjesen e siperme te rrjedhes se tij (psh: rezervuari i bacungut Verionit etj) qe do te luanin rolin e rregullatorit te prurjeve duke kapur ujrat e tepruara ne stinen e shirave per t'i leshuar ato gradualisht ne stinen e thatë duke i sherbyer keshtu si buqesise me ujra per vaditje edhe estetikes per “sektorin urban” te

lumit. Ne ndotjen e lumit ndikojne gjithashtu edhe ujrat qe rrjedhin nga fusha e grumbullimit te mbetjeve urbane e cila gjendet shume prane brigjeve te ketij lumi

4.3 NDERTIMET ARBITRARE MBI BRIGJE

Gjate gjithe periudhes se tranzicionit duke filluar nga fillimet e viteve '90, Zeses i eshte shtuar edhe nje rrezik tjeter. Jane ndertimet e pastuduara qe kane nxituar te ngrihen mbi brigjet e tij shpesh here duke u futur edhe brenda shtratit te lumit duke krijuar keshtu barierra te perhershme qe ngushtojne ndieshem seksionin e lumit. Keto ndertime me efektet sociale qe mund te prodhojne konsiderorohen sot si nje pike mjaft kritike sa here diskutohet problemi i sistemimit te lumit Zeze. Eshte ky nje problem shume i mprehte, i cili duhet te merret seriozisht nga autoritetet e pushtetit qendor apo vendor dhe te adoptohen zgjidhjet me racionale ne te mire te ekologjise se lumit dhe te komunitetit te Fush-krujes ne teresi.

Paraprakishte eshte domosdoshmeri te kualifikohet dhe kuantifikohet eksistenza e ketyre objekteve, te evintohen objektet me problematike qofte per persa i perket efektit ne seksionin e lumit, qofte per pengesat qe paraqesin ne sistemimin e shpateve, apo demet e shkaktuara ne aspektin estetik dhe funksionalorekreative.Pastaj duhet te mundesojme nje bashkepunim me konstruktiv midis pushtetit vendore dhe institucioneve kompetente te pushtetit qendrore (Policia Ndertimore) per te mundesar lirimin e hapesirave te domosdoshme per mirefunkcionimin dhe per miradministrimin e Zeses.

4.4 EROZIONI

Erozioni eshte nje fenomen tjeter qe ka ndikuar negativisht ne situaten e krijuar ne lumin Zeze. Duke pasur parasysh natyren e shkembinjeve te brigjeve lumore, nderhyrjet shpesh here te pastuduara mbi to si edhe shkaterrimin e gjelberimit mbrojttes te tyre, fenomeni i erozionit eshte theksuar me teper gjate ketyre 15 viteve te fundit. Megjithate te dhena sasiore mbi rolin e tij ne degjenerimin e profilit te lumit aktualisht nuk disponohen. Do te ishte e nevojshme ndermarrja e nje studimi te detajuar nga pikpamja gjeologoinxhinierike dhe topografike ku te mund te evidentohet gjendja e shpateve, profili gjatesor i shtratit te lumit si edhe thellesia e tij. Gjithashtu eshte e nevojshme te evidentohen me saktesi zonat me te uleta te brigjeve qe paraqesin rrezikshmeri nga permbytjet me mundesine e percaktimit te segmenteve ku eshte e nevojshme ndertimi i argjinaturave mbrojtese.

5. NDIKIMET E NDOTJEVE TE LUMIT ZEZES NE SHENDETIN E POPULLSISE

Edhe pse nuk eshte ndermare nje studim i mirefillte dhe i detajuar qe te beje nje vleresim te specifikuar te ketij ndikimi nga informacionet qe vijne

Nga drejtorite e shendetit dhe ajo spitalore , si dhe nga konklusionet e nje studimi kompleks mjedisore shqetesimet jane te shumta dhe te niveleve te ndryshme.

Gjithashtu efekte te ndjeshme negative te ndotesve rezultojne mbi faunen dhe floren e lumit, e cila eshte pothuajse inegzistente, si edhe nepermjet ujit per vaditje ndikon ne uljen e prodhueshmerise se kulturave bujqesore te fermereve te zones.

5.1 OBJEKTIVAT

Sigurimi i kushteve mjedisore te pershatshme per jeten ne qytet, nepermjet:

Pastrimit te lumit nga mbetjet inerte dhe sistemimi i shpateve;

Veshja e brigjeve te Zeses me peme e gjelberim;

Krijimi i zonave rekreative dhe sportive per gjate brigjeve;

Krijimi i lidhjeve sa me te mira midis dy pjesave te qytetit ne brigjet e ndryshme;

Zgjidhja e problemeve te shkarkimit te ujrale te zeza ne Zeze;

5.2 METODOLOGJIA

Ne te gjitha fazat e realizimit te kesaj projekt zbatimi te kihet parasysh plotesimi i kerkesave ne baze te standartreve dhe kushteve teknike te projektimit, ne baze te percaktimeve te Ligjit dhe Rregullores se Urbanistikes.

Ne te gjitha llogaritjet tekniko-ekonomike ne fazen e projekt-Zbatim se do te behen me cimimet referuar V.K.M. Nr. 629, dt 15/07/2015.

Volumet e punes do te paraqiten sipas zerave te ndara sipas proceseve.

Te gjitha materialet dhe zgjidhjet teknike qe do te ofrohen, do te paraqiten edhe ne version elektronik.

6. ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

DISA TË DHËNA PËR MBROJTJEN NGA LUMENJTË

Me kerkesat e popullsise, lumenjte gjithnjë e me shume janë shfrytezuar per furnizimin me energji elektrike, furnizimin me uje, ujite dhe lundrim. Jane bere ndryshime ne drejtimin e ujit nga inxhinieret te cilet janë perpjekur ta sistemojnë lumin dhe te jete i qendrueshem.

Studimi i lumbit, i cili mund te perkufizohet si “nje proces qe perfshin ndertimin e mbrojteve per gjate rrjedhjes per arritjen e disa qellimeve” ka objektivat e me poshtem:

1. Kontrollin e permbytjeve (te ndaloje permbytjen e zonave rrethuese duke siguruar nje kalim te sigurt te rrjedhjes pa kaluar mbi brigje);
2. Stabilizimin e drejtimit te lumbit (te mos lejoje lumin qe te ndryshoje rrjedhen e tij duke krijuar ne kete menyre gerryerjen e brigjeve);
3. Kontrollin e sedimentit (te transportoje me efikasitet ngarkesen e sedimentit); dhe
4. Drejtimi i rrjedhjes (te stabilizoje nje drejtim te caktuar rrjedhjeje).

6.1 KUR NDODHIN GERYERJET E BRIGJEVE.

Kur furnizimi me lende te ngurte ne nje rrjedhje zvogelohet me shume se kapaciteti i tranportimit lokal deficit i lendes se ngurte do te plotosohet nga erozioni i shtratit dhe brigjeve e cila rezulton ne ndryshimin e lartesise se shtratit dhe ne gjeresi. Ky proces njihet si geryerje e seksionit te lumbit..

Geryerja ndodh: (a) ne vende ku lumi eshte i ngushte (ferkimi me brigjet); (b) ne pjeset e poshtme te ndertimeve hidraulike; (c) ne pjesen e poshtme te nje pellgu te formuar ne shtrat si pasoje e heqjes se sasive te medha te reres dhe zhavorit per qellime ndertimi; (d) prane bashkimit te dy lumenjve; (e) ne nje rrjedhe ku shkarkimi rritet si pasoje e shfrytezimit te ujit per projekt te ndryshme, por ngarkesa e materjalit te ngurte dhe masa qendrojne te njejtë; dhe (f) ne rrjedhen qe derdhet ne liken ku niveli i ujit bie duke shkaktuar nje skarpate te siperfaqes se ujit qe rrjedh, ndersa shkarkimi dhe masa e materjalit te ngurte mbeten konstante.

6.2 KUR NDODHIN MBUSHJET E SHTRATIT TE LUMIT

Mbushja e shtratit paraqet nje ngritje te nivelit te shtratit me kalimin e kohes dhe ndodh shume shpesh ne pjesen e siperme te tij. Mbushja ndodh kur ngarkesa e materjalit te ngurte qe hyn diku eshte me e madhe se ajo qe del gjate te njejtes kohe duke lene nje raport pozitiv.

Mbushja ndodh kur: (a) shpejtesia mesatare ulet per shkak te efektit te kthimit te ujit te nje ndertim hidraulike; (b) uji i paster largohet nga nje rrjedhje aluviale per qellime ujite apo qellim tjeter; dhe (c) ka nje rritje te ngarkeses se materjalit te ngurte ne nje zone te caktuar per shkak te hapjes se portave te diges. Me fjale te tjera mbushja rezulton prej uljes se shpejtesise se rrjedhjes dhe shkarkimit, rritjes se ngarkeses dhe mases se materjalit te ngurte, etj.

Duke patur parasysh sa me siper lumi i Zeses kerkon nje studim te per gjitheshme dhe te percaktoje elemente dhe kriteret kryesore te mbrojtjes nga lumi.

Ne kete projekt jane ruajtur principet kryesore dhe jane kryer studimet hidrologjike per zonen qe mbrohet nga lumi dhe jemi te mendimit se nuk do te ndikoje prurja e llogaritur per perqindje te ndryshme ne kete zone te seksionit te lumbit.

Gerryerjet lokale ndodhin rreth ndertimeve hidraulike. Zakonisht ndodh si rezultat i me poshtem:

- (a) zenies se pjeseshme te rrjedhes nga struktura mbajtese te urave, etj;
- (b) shpejtesi e madhe e rrnymave qe con ne gerryerje te shtratit i cili mund te mbulohet apo jo nga uji;
- (c) shpejtesi e madhe e ujit nga kanalet e derdhjes.

Ne te gjitha keto raste, niveli i shtratit ne afersi te strukturave eshte me i vogel si rezultat i nderveprimit midis rrjedhjeve me shpejtesi te larte dhe modifikimit ne menyren e rrjedhjes.

Nje prej problemeve kryesore ne lidhje me gerryerjen lokale, eshte njohuria e pamjaftueshme e menyres se rrjedhjes dhe shperndarjes se shpejtesise e ndikuar nga prezenca e nje bllokimi. Ndryshimi i karakteristikave te rrjedhjes prane pjeses bllokuese, ndryshon forcat qe veprojne mbi shtrat dhe zakonisht con ne ndryshimin e topografise se tabanit. Ky ndryshim ne topografine e tabanit con ne nje ndryshim te ri ne rrjedhje e cila ndryshon perseri forcat qe veprojne mbi shtrat, dhe keshtu me rradhe.

Ne rast se perdoren gure per mbrojtjen e brigjeve, guret e perdonur per mbrojtjen e skarpates duhet te jene shume te rende per te perballuar forcen e rrjedhjes. Masa minimale e kerkuar e gurit per mbrojtjen e skarpates mund te gjendet nga analizat e stabilitetit te gureve individual kundrejt rreshqitjeve dhe permbytjeve. Varet ne shpejtesine e rrjedhjes, formen e gurit, gravitetin perkates dhe madhesine e skarpates. Si rregull, mund te perdoren gure qe peshojne 40 deri 50kg. Ne literature eshte paraqitur nje formule ne formen:

$$Ds = (0.023 \text{ ne } 0.046) \cdot U^2$$

Ketu Ds tregon madhesine e gurit ne m dhe U perfaqeson shpejtesine e rrjedhes ne m/s. Rekomandohet te perdoret koeficient me i larte.

Trashesia e veshjes me gure mbi anen e lumbit eshte llogaritur me ekuacionin empirik .

$$T = 0.06 \cdot Q^{1/3}$$

Per rrjedhje te medha rekomandohet koeficienti 0.04 ne vend te 0.06.

6.3 TEORIA E FORCËS TËRHEQËSE

Forca hidro-mekanike qe krijohet nga rrjedhja e ujit ne kanal, shkakton sforcimet tangenciale ne dyshemen e tij. Materiali I shtratit, nga ana tjetër, I reziston presionit deformues duke krijuar një forcë tërheqëse. Teoria e forcës tërheqëse thotë se sforcimet tangenciale I nxitur nga rrjedhja nuk duhet të prodhojnë forcë më të madhe se forca tërheqësese rezistencës së materialit të shtratit. Kjo forcë tërheqëse e

rezistencës së materialit të shratit krijon presioni e lejuar ose kritik deformues të tij.Në një rrjedhë të njëtrajtshme sforcimet tangenciale është e barabartë me komponentin real të forcës gravitacionale që vepron në trupin e ujit parallel me dyshmenë e kanalit.Sforcimet tangenciale mesatar është I barabartë me:

$$\tau = \gamma \cdot R \cdot S \quad (1)$$

Ku:

τ - sforcimet tangenciale mesatar,(Pa)

γ - masa njësi e ujit,9810N/m³(at 15.6°C)

R - rreza hidraulike,m

S - pjerrësia mesatare e shratit,ose pjerrësia e energjisë,m/m.

Sforcimet tangenciale maksimal për një kanal të drejtë ndodh në shtratin e kanalit dhe është më I vogël ose I barabartë me presionin deformues në thellësinë maksimale.Sforcimet tangenciale maksimal përllogaritet si më poshtë:


$$\tau_d = \gamma \cdot d \cdot S \quad (2)$$

Ku:

τ_d - sforcimet tangenciale maksimal, (Pa).

d - thellësia maksimale e rrjedhës, (m).


Sforcimet tangenciale në kanale nuk shpërndahet njëtrajtësisht përgjatë perimetrit të lagur të një kanali.Një shpërndarje tipike e presionit deformues në një kanal trapezoidal tenton të shkojë drejt zeros në qoshet me një maksimum në shtratin e kanalit,në vijën e tij qëndrore,dhe maksimumi për skrapatat anësore ndodh rreth 1 së 3-tës së poshtme të skrapatës,siç është ilustruar në figurën 7.7



Shërndarja e sforcimeve tangenciale

Për kanale trapezoidale të mbushur me zhavorr ose me veshje me gurë ,tipi veshje me gurë,tipi riprap që i kanë skrapatat e tyre më të pjerrëta se 3horizontale deri 1vertikale,duhet marrë gjithashtu në konsZBATIMratë qëndrueshmëria e skrapatës anësore.Kjo analizë kryhet duke krahasuar raportin e

forcave tërheqëse midis dy skarpatave anësore dhe dyshemasë së kanalit me reportin e presionit deformues të ushtruar mbi anët dhe fundin e kanalit. Raporti i presioneve deformuese mbi anët dhe fundin e kanalit trapezoidal, K_1 është dhënë në Figurën dhe rapporti I forcës tërheqëse, K_2 është dhënë në Figurën e me poshteme. Këndi i prehjes për forma dhe përmasa të ndryshme të shkëmbit është paraqitur në figurën Madhësia e kërkuar e shkëmbit për skarpatet anësore llogaritet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:



Varësia e sforcimit tangenciale anësor të kanalit nga sforcimi tangencial fundor të tij, K_1 .

$$(D_{50})_{sides} = \frac{K_1}{K_2} (D_{50})_{bottom} \quad (3)$$

Ku:

(D_{50}) - madhësia mesatare e veshjes me gurë, tipi veshje me gurë, tipi riprapit, m.

(K_1) - rapporti I shpërndarjes së presionit deformues mbi anët dhe fundin e kanalit trapezoidal (Figura 7-8)

(K_2) - rapporti I forcës tërheqëse mbi anët dhe fundin e një kanali trapezoidal (Figura 7-9)

Rrjedhja rrith një ktheshë në një kanal të hapur i shtyn forcat centrifugale për shkak të ndyshimit në drejtimin e rrymës. Kjo sjell një superngritje të sipërfaqes së ujit në pjesën e jashtme të kthesave dhe mund të shkaktojë përplasjen e rrjedhës mbi anën e kanalit, nëqoftëse nuk sigurohet një zonë e paprekur nga uji. Kjo superngritje mund të llogaritet me anë të ekuacionit të mëposhtëm.

$$\Delta d = \frac{V^2 \cdot T}{g \cdot R_c} \quad (4)$$

Ku:

Δd - diferenca në ngritjen e sipërfaqes së ujit midis bregut të brëndshëm dhe atij të jashtëm të kanalit në kthesë, m


V - shpejtësia mesatare, m/sek.

T - gjerësia e sipërfaqes së kanalit,m.

g - nxitimi i rënies së lirë, 9.81m/s^2 .

R_c - rrezja e vijës qëndrore të kanalit.

Ekuacioni 4 është i vlefshëm për kushtet nën-kritike të rrjedhjës. Ngritja e sipërfaqes së ujit në bregun e kanalit të jashtëm do të jetë $\frac{\Delta d}{2}$ më e madhe se ngritja e sipërfaqes së ujit në vijën qëndrore (ngritja mesatare e sipërfaqes së ujit menjëherë përparrë kthesës) dhe ngritja e sipërfaqes së ujit në bregun e kanalit do të jetë $\frac{\Delta d}{2}$ më e vogël se ngritja e sipërfaqes së ujit në vijën qëndrore.



Raporti I forcës tërheqëse, K_2 .

Rrjedha përreth kthesave krijon gjithashtu rryma dytësore që imponojnë presione deformuese më të mëdha në anët dhe pjesën fundore të kanalit, kjo me pjesët e drejta. Në figurën janë ilustruar zonat me sforcimet tangenciale të lartë në kthesa.

Sforcimet tangenciale maksimal në një kthesë është një funksion i raportit të kurbaturës së kanalit në gjerësinë e dyshemesë. Ky rapport si dhe sforcimet tangenciale maksimal në kthesë rritet kur kthesa bëhet më e mprehtë.

Sforcimet tangenciale maksimal në kthesë mund të përllogaritet duke përdorur reportin e mëposhtëm.

$$\tau_b = K_b \cdot \tau_d$$

Ku:


τ_b - sforcimet tangenciale në kthesë, Pa.

K_b - funksioni i $\frac{R_c}{B}$ (shiko figurat 7.12)

B - gjerësia e dyshemesë së kanalit, m.

R_c - rrezja e vijës qëndrore të kanalit.

τ_d - sforcimet tangenciale maksimal i kanalit,Pa.



Shpërndarja e sforcimit tangencial në kthesat e kanalit

Presioni i rritur deformues i prodhuar nga kthesa vazhdon në drejtimin e rrymës për një distancë L_p , siç tregohet në Figurë. Kjo distancë mund të përllogaritet duke përdorur raportin në vazhdim.

$$L_p = \frac{0.736 R^{7/6}}{n_b}$$

Ku: L_p - gjatësia e mbrojtjes (gjatësi e presionit deformues të rritur për shkak të kthesës) poshtë pikës së tangents, m.

n_b - ashpërsia e Maningut në kthesën e kanalit.

R - rezja hidraulike, m

Sforcimet tangenciale

Sforcimet tangenciale I pranueshëm ose kritik në një kanal përcakton forcën që duhet për të filluar lëvizjen e shtratit të kanalit ose materialit të veshjes. Tabela 7-5 pasqyron vlerat e presionit deformues të pranueshëm për veshjet industrial, bimore, apo ato me thurrje. Sforcimet tangenciale I pranueshëm për tokat jokohezive eshtë një funksion I diametrit mesatar të materialit të kanalit siç është treguar në Figurën 7-13. Për madhësi, guri dhe veshje me gurë, tipi veshje me gurë, tipi riprapit të papërfshira në Figurën 7-13, sforcimet tangenciale I pranueshëm jepet me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

$$\tau_p = K_p \cdot D_{50} \quad (7.17)$$

Ku:

τ_p - sforcimi tangencial I pranueshëm, Pa.

D_{50} - madhësia mesatare e veshje me gurë, tipi riprapit, m.

K_p - koeficient = 628

Për materialet kohezive , indeksi I plasticitetit siguron një udhërrëfyes të mirë për përcaktimin e presionit deformues të pranueshëm , siç është ilustruar në Figurën 7.14.

6.4 BRIGJET E LUMIT

Brigjet e lumit perbejne seksionin e siperm dhe te poshtem. Bregu i poshtem, pjesa nen uje, ka funksionin e nje themeli per te mbajtur bregun e siperm dhe eshte me i prekshem ndaj gerryerjeve. Renia e prites shkaktohet nga gerryerjet e bregut te poshtem, vecanerisht fundit te tij. Renia mund te jete e shpejte, sidomos kur ka nje shtrese ranore, e cila mund te merret nga nje prurje e trembyeshme dhe keshtu mund te shkaktohet renia e krahut te siperm te prites. Bregu i siperm eshte pjesa midis nivelit te ulet dhe nivelit te larte te ujit. Veprimi ne kete pjese te bregut eshte me i ashper kur rryma vepron normalisht ne prite. Gjithshtu gjate periudhes kur plota eshte e larte bregu gerryhet si pasoje e rrymave te forta

Per llogaritjen e trashesise se veshjes me beton mund te perdonim formulen e meposhtem

$$t = (0.03 \div 0.035) \cdot a \cdot h \cdot v^{1/2}$$

ku t = trashesia e veshjes

v = shpejtesia e ujit ne kanal

h = lartesia e ujit ne kanal

a = koefiqient qe varet nga lloji i tokes

ky varet:

Per toka argjilore dhe suargjilore te ngjeshura $a = 0.8$

Per toka suargjilore mesatare $a = 1.0$

Per toka suranore $a = 1.5$

Per toka ranore $a = 2.0$

Sipas Alltunit trashesia e veshjes se lumenjeve ose e sistemimeve te perrenjve me beton arme
llogaritet sipas formules:

$$t = 0.05 \frac{V\sqrt{2}}{3} \text{ (ne metra)}$$

ku :

V - shpejtesia e rrjedhes ne pikun e plotes ne vendin e perforcimit (m/s)

Duke patur parasysh sa me siper BO “ANGERBA”shpk & “ERALD-G”shpk do te pergartisi projektin si me poshte vijon.

Pergatitjen e skemes finale per punimet e listuara ne fletet e dhena per zonen qe do te trajtohet per mbrojtjen nga lumi te Fush-krujes, sic kerkohet ne detyren e projektimit.

Perfundimi i llogaritjeve hidraulike

Pergatitja e profilave terthore per cdo pikete..

Pergatitja e profilave gjatesore per bregun e majte dhe bregun e djathte te lumit

Vizatimet duhet te jene te qarta dhe koncize dhe te prezantohen ne nje menyre te tille qe te mund te kuptohen dhe interpretohen lethesisht nga kontraktori. Planimetrite dhe profilat gjatesore dhe terthore te vizatohen ne shkallen e kerkuar sipas detyres se projektimit.

Pergatitja e specifikimeve teknike per te gjithe zerat e punes te perfshira ne projekt.

Pergatitja e preventivave per te gjitha llojet e punimeve.

Dokumentat e projekt- zbatimit se permbajne planimetri, profila e detaje ku jane hedhur menyrat qe propozohen per mbrojtjen nga lumi.

Para fillimit te projektit te vepres jane kryer punimet topografike per te saktesuar gjendjen ekzistuese, azhornimin e planimetrike, profilat gjatesore dhe terthore te linjave te sistemeve qe ne trajtojme.


“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje

Planimetrite dhe profilat gjeatesore do te kene te shenuar shkallen e vizatimit te tyre. Do te hartohet planimetri aksiale dhe profila terthore per ndertimin e vepres.


ZGJIDHJA TEKNIKE

Pas permbytjeve te Dhjetorit 2010 Bashkia e Fushe Krujes hartoi Projekt zbatimi per mbrojtjen nga permbytjet ne qytetin e Fushe Krujes.

Ne vitet 2010 deri 2013 eshte nderhyre me dy lote me gjatesi 950 m duke filluar nga Ura Hekurudhore.



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje



Ne projektin e hartuar prurja llogarite se me 1 % siguri eshte konsideruar $520 \text{ m}^3/\text{sek}$.
Sekzioni eshte projektuar me baze $5.9-7.9 \text{ m}$ me skarpata $1 : 1.25$ me lartesi uji 5.7 m .
Kjo zgjidhje eshte me elemente Beton Arme parapet me lartesi 1.3 m mbi terren. Skrapatat e lumit jane te veshur me blloqe betoni me trashesi 25 dhe 20 cm dhe me gabiona me trashesi 40 cm me permasa $3 \times 1 \text{ m}$.

Duhet te konsiderohet fakti se ne botimet e Buletineve te Akademise se Shkencave te vitit 1984 prurja e lumbit Zeze me 1 % siguri tek ura ne Fushe Kruje jane llogaritur $408 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Ne permbytjet e viteve 2015, 2016 dhe 2017 rezultoi se uji nuk e kaperceu parapetin por jo e gjithe prurja ishte brenda sektionit te lumbit pasi doli jashtë shtratit ne fshatin Arrameras dhe mbi uren ne qender te qytetit Fushe Kruje.

Nga matjet topografike te kryera ne kete segment te zbatuar te lumbit Zeze vihet re se kemi mbushje te shtratit te lumbit deri ne 0.5 deri 1 m. Ne ngritjen e nivelit te shtratit te lumbit kane ndikuar dhe faktore te tille si kemba e ures egzistuese ne qender Fushe Kruje. Kjo mbushje vjen gjithashtu dhe si rezultat mos mirembajtjes se shtratit te lumbit Ishem (Pjese e ketij lumi eshte dhe lumi Zeze) ne te gjithe gjatesine e tij duke filluar nga derdhja ne det.

Nisur nga faktoret e mesiperme dhe nga fakti i ndryshimeve klimaterike dhe natyrore ne pellgun shimbledhes te lumbit Zeze do te veprojme sime poshte :

Llogaritjet e sektionit te lumbit do te behen per prurjen llogaritese me 1 % siguri $620 \text{ m}^3/\text{sek}$ dhe do te kontrollohen per prurjen me 0.5 % siguri $776 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Nga llogaritjet e sektionit egzistues te matur ne segmentin ku eshte nderhyre ne vitet 2011-2013 vihet re se nuk na e perballon prurjen tone. Pra eshte domosdoshmeri qe te nderhyhet ne kete segment per ta kthyer ne kushte te projekti per te perballuar prurjet e llogaritura.

Projekti propozon qe nderhyrja ne lumen Zeze te filloje qe nga nderprerja e lumbit me uren e Autostrades Fushe Kruje -Milot.

6.5 MBROJTJE NE SEGMENTIN PIK 1-PIK 29

(Ura e Autostrades - Ura Hekurudhore)

Llogaritjet e sektionit te lumbit per kete pjese nga pik 1-10 Jane bere per prurjen llogaritese me 1% siguri per $1006 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Ndersa eshte kontrolluar sektioni i pranuar per prurjen kontrolluse me 0.5 % siguri me $1260 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Duhet thene se ne Pk.10 derdhet Perroi i Bardharit.

Kurse nga pik 10 deri ne 29 llogaritjet e sektionit te lumbit Jane bere per prurjen llogaritese me 1 % siguri per $620 \text{ m}^3/\text{sek}$. Ndersa eshte kontrolluar sektioni i pranuar per prurjen kontrolluse me 0.5 % siguri me $776 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Nga Pk.1 deri ne Pk.10 ne nje gjatesi prej 450 m gjeresia e lumbit ne pjesen e poshteme do te jete 20 m me pjerresi te skrapatave 1:1.5. Ndersa ne segmentin Pk.10 deri Pk.29 me gjatesi 939 m, qe korespondon me Uren Hekurudhore gjeresia e bazes se poshteme te lumbit do te jete 15 m.

Projekti ka parashikuar qe ne kete segment do te kryhen vetem germimet ne shtratin e lumbit per faktin se largohemi nga zona e banuar dhe nga rreziku i niveleve te larta te lumbit. Dherat e dala nga germimi do te depozitohen ne brigjet e lumbit ne te dy anet e tij duke krijuar keshtu dhe argjinatura prej dhei.

Ne kete segment eshte parashikuar te nderhyhet ne te dy urat egzistuese si ate te Autostrades dhe ne ate te Hekurudhes duke bere shtrimin me shtrese betoni me zgare 8mm me dimension $20 \times 20 \text{ cm}$ te tabanit te lumbit ne keto vepra.

Eshte parashikuar gjithashtu ndertimi i mureve prej B/A ne kater pozicione. Ne te dale te ures Hekurudhore ne te dy anet me gjatesi 40 m. Po ashtu ne te hyre dhe ne te dale te ures se Autostrades ne krahun e majte ne dalje me gjatesi 45 m dhe ne hyrje ne te djathte te rrjedhes me gjatesi 20 m.


Eshte parashikuar mbrojtja me gabiona ne dy segmente ana e majte e rrjedhes se lumbit ne Pk 8 me gjatesi 40 m dhe Pk. 12 me gjatesi 20 m.

Llogarite hidrologjike e te lumbit te Zeses per keto segmente jepen ne tabelat e me poshteme :

Llogarite Hidraulike Pik 1-10 1% siguri

PRERJE TERTHORE

Lumi ne forme trapezi



T E D H E N A T

Gjeresia e kanalit (baza)	b=	20.0
Koefic.Skarpates (m)	m=	1.5
Lartesi e ujit ne pjesen qendrore	h=	5.92
Koeficenti i ashpersise (n)	n=	0.0250
Pjerresia e kanalit	i=	0.00317


LLOGARITJET HIDRAULIKE

Siperfaqja e seksionit	S=	170.97
Perimetri i lagur	P=	41.34
Rrezja hidraulike	R=	4.14
Shpejtesia e ujit	V=	5.88
Prurja	Q=	1006.15
	C=	51.40

Llogarite Hidraulike Pik 10-29 1% siguri

PRERJE TERTHORE

Lumi ne forme trapezi



T E D H E N A T

Gjeresia e kanalit (baza)	b=	15.0
Koefic.Skarpates (m)	m=	1.5
Lartesi e ujit ne pjesen qendrore	h=	5.16
Koeficenti i ashpersise (n)	n=	0.0250
Pjerresia e kanalit	i=	0.00317

LLOGARITJET HIDRAULIKE

Siperfaqja e seksionit	S=	117.34
Perimetri i lagur	P=	33.60
Rrezja hidraulike	R=	3.49
Shpejtesia e ujit	V=	5.30
Prurja	Q=	621.42
	C=	50.34

6.6 MBROJTJE NE SEGMENTIN EGZISTUES PIK 29 -PIK 61

(Ura Hekurudhore – Perfundimi i nderhyrjes egzistuese)

Llogaritjet e seksionit te lumbit ne kete pjese jane bere per prurjen llogaritese me 1 % siguri per $620 \text{ m}^3/\text{sek}$. Ndersa eshte kontrolluar seksioni i pranuar per prurjen kontrolluse me 0.5 % siguri per $776 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Segmenti i zbatuar ka nje gjatesi prej 950 ml me nje pjerresi te tabanit te shtratit prej 0.04 %.

Ne distance 360 ml nga ura hekurudhore ndodhet ura auto ne qender te qytetit Fushe Kruje. Projekti ka parashikuar qe ura egzistuese te prishet dhe ne vend te saj te ndertohet nje ure e re me HD = 20 m me nje hapsire drite. Projekti ka parashikuar qe ne kete segment te kalohet me seksion kendrejt me mure vertikale prej betoni te armuar. Kjo zgjidhje kushtezohet nga fakti i ndertimeve qe ndodhen ne te dy anet e lumbit. Do te ruhet hapsira egzistuese ne bazen e siperme dhe keshtu ulet lartesia e mureve deri ne kuoten e tokes natyrale.

Kjo zgjidhje nga ana hidraulike permireson ashpersine duke bere rritjen e shpejtesise se levizjes se ujit.


Po ashtu duhet thene se kjo zgjidhje kushtezohet dhe nga fakti i ures se re qe do te ndertohet. Aktualisht ura eshte me dy hapsira drite nga 8 m sejtila. Per te bere te mundur perballimin e prurjes llogaritese nevojitej ngritia e saj mbi nivelin e rruges egzistuese. Kalimi ne kete zgjidhje e elemision kete ngritje.

Projekti ka parashikuar gjithashtu qe ne vendet ku ndertesat egzistuese jane prane parapetit egzistues do te kalohet me ndertim te perdeve me pilota b/a per te mos rrezikuar shembjen e tyre.

Po ashtu eshte parashikuar qe ne te dy anet te ndertohet nje mur gabioni me gure kave me permasa (2×0.5) m.

Duhet thene se elementet beton arme si parapeti ashtu dhe pllakat do te hiqen me kujdes dhe do te dergojen ne nje vend depozitimi ku te caktohet nga Bashkia.

Llogaritja Statike e murit.



“Ndertim i Ures mbi Lumin Zeze dhe Mbrojtje nga Permbytjet ne qytetin Fushe Kruje”, Bashkia Kruje

$$\sigma_{\text{max}} = \sum G / b \pm (6 * \sum G * e_i) / b^2 \pm (6 * E * g) / b^2$$

$$\sigma_{\text{murit}} = 0.5 * 5 * 25 = 62.5 \text{ KN}$$

$$\sigma_{\text{pr}} = 0.6 * 2.95 * 25 = 44.25 \text{ KN}$$

$$\sigma_{\text{dhet}} = 5 * 20 = 100 \text{ KN}$$

$$e_1 = 0.22 \text{ m}$$

$$\varphi = 30^\circ \Rightarrow \tan^2(45 - 30/2) = 0.33$$

$$e_2 = 0$$

$$e_3 = 0.975 \text{ m}$$

$$E = \frac{1}{2} * \gamma * H^2 * \tan^2(45 - 30/2) = 0.5 * 20 * 5.6^2 * 0.33 = 104.4 \text{ KN}$$

$$g_1 = 1.87$$

$$\begin{aligned} \sigma_{\text{max}} &= \sum G / b \pm (6 * \sum G * e_i) / b^2 \pm (6 * E * g) / b^2 \\ &= (62.5 + 44.25 + 100) / 2.95 \pm (6 * 62.5 * 0.22) / 2.95^2 \pm \\ &\quad (6 * 100 * 0.975) / 2.95^2 \pm (6 * 104.4 * 1.87) / 2.95^2 \\ &= 70.1 \pm 9.48 \pm 67.2 \pm 134.6 \end{aligned}$$

$$\sigma_{\text{max}} = 1.28 \text{ daN/m}^2$$

$$\sigma_{\text{min}} = 2.12 \text{ daN/m}^2$$

Kontrolli ne permbysje:

$$K = M_m / M_p > 1.5$$

$$M_m = \sum G * e_i = (62.5 * 1.69) + (44.25 * 1.475) + (100 * 2.45) = 105.63 + 65.3 + 245 = 415.93$$

$$M_p = E * 1.87 = 104.4 * 1.87 = 195$$

$$K = M_m / M_p = 415.93 / 195 = 2.13 > 1.5$$


Kontrolli ne rreshqitje :

$$K_r = (\sum G * f) / E > 1.3$$

$$(\sum G * f) = (62.5 + 44.25 + 100) * 0.58 = 119.9$$

$$K_r = (\sum G * f) / E = 119.9 / 104.4 = 1.15$$

Armimi



$$\sigma_1 = \sigma * H * \tan^2(45 - \varphi/2)$$

$$= 20.5 * 5 * 1/3 = 33.3 \text{ KN}$$

